

ZBULIME ARKEOLOGJIKE TË RËNDËSISHME NË ZAGORI, GJIROKASTËR!

Gjatë punimeve për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës Çajup-Zagorie, janë identifikuar dy site me vlera të veçanta arkeologjike pranë fshatit Sheper. Sipas vlerësimeve paraprake të specialistëve të **DShA** dhe **DRTK Gjirokastër**, bëhet fjalë për gjurmët e një tempulli antik të shek. III-II p.e.s., si dhe struktura banimi të së njëjtës periudhë.

Aktualisht po përgatitet projekti për kryerjen e gërmimit të shpëtimit, i cili planifikohet të zhvillohet gjatë muajit maj, pas miratimit nga KKTKM.



TAKIM NË QYTETIN ANTIK TË BYLISIT

Më 5 maj 2025, në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit mes IKTK-së dhe AICS, u zhvillua një takim në terren me përfaqësues të **IKTK, AICS, NJAKPA Apoloni-Bylis** dhe konsulentët e kontraktuar, për të koordinuar punën për hartimin e projektit të Qendrës MultifunkSIONALE dhe Planit të Konservimit të Parkut Arkeologjik të Bylisit.

Ky projekt përbën një hap të rëndësishëm në zbatimin e Planit të Menaxhimit të parkut, të cilin IKTK mbështet dhe ndjek me përkushtim, në funksion të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë sonë kulturore.



INSPEKTIME NË TERREN

Specialistët e IKTK vijojnë ndjekjen nga afër të punimeve restauruese në tre monumente të rëndësishme:

- **Kisha e Shën Sotirit në Kërçisht**
- **Manastiri i Ardenicës në Lushnje**
- **Kisha e Shën Mërisë në Bishqethëm**

Restaurimi i tyre është një hap i rëndësishëm në ruajtjen e identitetit dhe vlerave tona historike.



SALONE DEL RESTAURO, FERRARA

Në datat 11-16 maj 2025, përfaqësues të IKTK morën pjesë në edicionin e 30-të të **Panairit Ndërkombëtar Salone del Restauro**, një nga ngjarjet më të rëndësishme për konservimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Takime me institucione, universitete dhe profesionistë nga fusha, prezantimi i rolit të IKTK-së dhe shkëmbime mbi teknikat bashkëkohore të restaurimit ishin në qendër të kësaj përvoje ndërkombëtare. Trashëgimia kulturore, një urë bashkëpunimi për zhvillim të qëndrueshëm!



KISHA E SHËN KOLLIT, XENGË – DIVJAKË

Specialistët e IKTK-së realizuan një vizitë inspektuese në këtë pasuri kulturore me vlera të veçanta, në kuadër të hartimit të projektit të restaurimit.

Ky është një hap i parë i rëndësishëm drejt ruajtjes dhe rivlerësimit të monumentit, duke garantuar mbrojtjen dhe transmetimin e trashëgimisë sonë kulturore për brezat e ardhshëm.



"KALORËSI I BABUNJËS"

"Kalorësi i Babunjës", statuja prej bronzi e zbuluar në **Babunjë të Divjakës**, vjen nga lashtësia në skenat ndërkombëtare. Pas restaurimit në Institutin Getty dhe ekspozimit në Los Angeles, ky dëshmitar i epokës arkaike ndodhet tani në Muzeun e Historisë së Natyrës në Vjenë, një ambasador 14 cm i trashëgimisë sonë mijërvjeçare.

